



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË GJASHTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 30.09.2020 (e Mërkurë), në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Valentina Hasani, Vehbi Rama, Rasim Terziqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, Zyra Ligjore, mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 27 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

z.Naim Pira, kryesuesi: Mirë se keni ardhur në seancën e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të ju përsërisht nënkryetarin e komunës, z.Hasan Aliu, juve anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë, media të informimit, shoqëri civile si dhe të gjithë të tjerët të pranishëm. Para se me kalu në miratimin e rendit të ditës dua të ju informoj që nga seanca e fundit e jashtëzakonshme e cila u mbajt para 10 dite. Kemi marr konfirmimin e ligjshmërisë së akteve nga zyra ligjore e MAPL-s. Aktet të cilat nuk janë konfirmuar si të ligjshme, detyrimisht jemi të obliguar që t'i shfuqizojmë vendimet, sepse biemi ndesh me ligjin. Duke e pasur parasysh faktin që sot kemi një agjendë mjaft të ngjeshur, ju lutem që ta respektojme rregulloren e punës. A ka dikush ndonjë pyetje, fjala është e juaja?

Tani kalojmë tek pyetjet dhe përgjigjet. Fjala është për ju.

zj.Mirlinda Sadiku: Përsërisht për kolegët asamblast, mediat, kryesues, nënkryetar, bord I drejtorëve si dhe të tjerët të pranishëm. Fatkeqësisht rrugës duke ardhur për në punë u takova me disa policë të stacionit policorë në Viti, Mjerisht ka rënë pllafoni në zyrën e intervistimeve. Prandaj, ne si lëvizje kemi bërë një kërkesë që të murrët parasysh kjo gjendja në stacionin policorë, sepse në luftën kundër Kovidit, bashkë me mantilbardhët kanë qenë edhe policët. Unë e kam thënë edhe hera tjera, që nga viti 2006 në këtë objekt nuk është bërë asnjë investim, ndërsa nëse e marrim përshebull Komunën e Gjilanit, ajo ka investuar mjaftueshëm në stacionin policor në Gjilan. Pse edhe ne si viti mos ta bëjmë një gjë të tillë, pasi që edhe buxhet kemi mjaftueshëm. Një pyetje tjetër për drejtoreshën e bujqësisë, pse nuk po bëhet ekzekutimi i vendimit në lidhje me dëmet që janë bërë në bujqësi, sidomos për fermerët e fshatit Skifteraj? Po ashtu kam edhe një pyetje për drejtorin e arsimit. Drejtor, dezinfektuesit janë ka fundi, material higjienik nuk kemi, ju na keni thënë që nuk do të mungojë materiali për kujdesin e shëndetit të nxënësve, mirëpo gjendja në teren nuk është kështu, ka shumë mungesë të materialit higjienik. Faleminderit!

z.Ali Bajrami: Faleminderit kryesues, përsërisht nënkryetar, kryesues, drejtorët, asamblastët. Kryesues, po I përmbahem rregullores. Kam pasur më shumë pyetje, mirëpo vetëm dy po I parashtroj. Për drejtorin e arsimit. Më intereson me ditë, si janë duke shkuar punët në shkollën e Goshives edhe të Zhitisë, në të cilat shkolla janë duke u

bërë disa punë shumë të mira? Ndërsa pyetjen tjetër e kam për drejtoreshën e shëndetësisë, për menaxhimin e situatës së pandemisë në Komunën e Vitisë. Një informatë në pika të shkurta. Faleminderit!

z.Bekim Aizi: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, asamblist, mediat, kryesues, nënkryetar, bord I drejtorëve. Unë mendoj që shqetësimi më i madh në këto kohë është zhvillimi i procesit mësimor në shkollën e Pozheranit, në të cilën shkollë është duke u punuar në pesë ndërrime dhe mësimi zgjatë vetëm 1:25 orë. I kemi parasysh të gjitha arsyet që kanë ndodhur, mirëpo këshilloj që të merret diçka në këtë drejtim, ndoshta edhe urgjente, sepse edhe është në rrezik shëndeti I nxënësve, duke e pasur parasysh numrin e madh të tyre. Ju lutem mundohuni dhe bëjeni një zgjidhje, sepse është vërtet problem që duhet pasur parasysh. Në kuadër të kësaj kam dhe një pyetje tjetër, që ndoshta dikush nga ju mundet me u përgjigj. Matja e temperaturës së nxënësve nëpër shkolla kryhet nga ana e korrierit të shkollës, kjo për mua është tmerr, krim. Kemi raste ku prindërit janë ankuar që mos t'iu matet fëmijëve temperatura më anë të aparatit që vendoset në kokë, e që ngjanë si armë. A ekziston ndonjë formë tjetër që shërben për matjen e temperaturës e që nuk shkakton frikë tek fëmijët. Për drejtorin e arsimit: pse e keni shkelur rregulloren e rekrutimit të drejtorëve në shkollën e Terpezës dhe Zhitisë? Për drejtorin e inspeksionit: drejtorë, tek pishat në Terpezë e keni rregulluar një asfalt që është bërë punë e mirë, mirëpo si ke lejuar ti që të bëhet i tërë ai germim në natyrë, që paraqet rrezik për banorët, për ta siguruar bazën e rrugës për asfalt? Keni bërë dëmtim për të rregulluar një asfalt. Për drejtoreshën e shëndetësisë. Kemi kontratën me KARITAS-in për shërbime shëndetësore. Kërkojë një informatë me shkrim për të gjithë të punësuarit që kryejnë shërbime shëndetësore, për numrin e tyre dhe punët që ata kryejnë. Faleminderit!

z.Remzi Saliu: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë kam një pyetje për drejtorin e arsimit: vallë, si qëndron puna me dy sekretarët e shkollave të mesme në Viti, kur dihet që në të dy shkollat ka skaduar mandati apo njëri është pensionuar, ndërsa tjetri ka lëshuar vendin e punës për detyrën e tij të re? Me ligj të punës me sa e di unë, tre muaj para përfundimit të mandatit ose lirim të vendit të punës, duhet të shpallet konkursi për plotësimin e vendit të punës. Në shkollën e mesme “Kuvendi I Lezhës”, në të cilën jam pjesë e mesimdhënësve, me ka rastisë me pa palë duke pritur kohë të gjatë, sepse punën e sekretarit e kryen një punëtorë i cili punon edhe si mesimdhënës. Vallë, a mundet që një punëtorë t'i kryej dy detyra? Pse nuk po shpallen vendet e lira për sekretar në shkollat e mesme? Faleminderit!

z.Taulant Haxhiu: I nderuar nënkryetar, kryesues, të nderuar asamblist. Unë kam një pyetje për asfaltimin e disa rrugëve që janë bërë në fshatin Terpezë, disa nga këto rrugë kanë përfunduar dhe disa të tjera kanë mbetur në gjysmë për shkak të mungesës së mjeteve. E dyta, ne si parti politike opozitare, kemi shprehur një shqetësim rreth mënyrës së të punësuarve në komunën tonë. Unë edhe hera tjera e kam thënë, që Komuna e Vitisë le përshtypje si me qenë e privatizime, të gjitha konkurset shpallen për njerëzit e LDK-së. ndërsa për ne si parti të tjera kamë përshtypjen që edhe nëse vdesmi nuk kemi për tu varros, sepse komuna është e privatizime dhe ne nuk jemi njerëz të LDK-së. Në këtë mënyrë kryetari i nëndegës më të madhe të LDK-së në Viti, z.Mufail Halabaku, është bërë drejtor në shkollën “Kongresi I Manastirit” në Pozheran, shefi I grupit parlamentar të LDK-së e ka punësuar rejen, drejtoresha e gjeodezisë dhe kadastrit e ka punësuar kumatën. Unë nuk e di nëse Komuna e Vitisë është e Sokol Halitit apo e qytetarëve. Kërkojë nga nënkryetari i komunës një sqarim rreth këtyre ngjarjeve. Faleminderit!

z.Sejdi Emini: Faleminderit kryesues! Po fillojë pikërisht të shkolla e Goshices, ku bashkëvendësi im pyeti për punimet në shkollë, po besojë që mundem edhe unë me dhënë përgjigje, jo me zëvendësua drejtorin, por duke qenë prezent aty çdo ditë, unë kam një falënderim të madh për banorët dhe prindërit e nxënësve të fshatit tonë. Sepse për 20 vite ata e kanë mbajtur gjallë, kanë bërë investime në të gjitha aspektet, kjo që po bëhet tani në këtë kohë. Nxemja qendrore dhe izolimi i shkollës, atë që e kam dëgjuar me veshët e mi nga disa punëkryes, që janë duke punuar aty, më shumë merakosen për tenderat që kanë përfunduar nëpër shkolla sesa cilësia e punës. Prapë po them, që një falënderim shumë I madh dhe I veçantë shkon për banorët të cilët nuk kanë kursyer as kohë e as mjete për të arritur këtu ku jemi. E dyta, sheshi në qendër të Vitisë. Vitia ka pasur nevojë për një shesh kah moti, mirëpo unë mendoj që më shumë është duke u bërë zgjerimi i parkut të qytetit sesa ndërtimi I një sheshi natyral, siç e kërkon qyteti i Vitisë. Sheshi natyral në Komunën e Vitisë, të gjithë e dimë që duhet të fillojë prej pasqyrës dhe të vie deri naltë. E kemi dhënë si propozim edhe më herët, kemi dhënë edhe alternativa për kahjet e rrugëve në qytet, që të mbyllet

përrocka, të bëhet si rrugë dhe ta merr Vitia pamjen e bukur dhe të kryhet një punë ashtu si duhet njëherë e përgjithmonë. Fusha në Sadovinës, mjerisht ajo fushë është duke u shkatërruar për mungesë të kujdesit institucional, kjo fushë kërkon së paku tribuna për diku afër tre mijë shikues. Po ashtu kërkon edhe një punëtorë pikërisht nga fshati Sadovinë, që ta mirëmbajë fushën. Gjithashtu më vjen mirë që nëpër disa fshatra po bëhen disa fusha me gomë e në disa të tjera fëmijët rrezikohen në çdo hapë që bëjnë, për shkak të kushteve të këqija të fushës apo asfaltimit. Interesant, se si po flitet për një avancim shumë të madh, e në anën tjetër kemi fshatë në Komunën e Vitisë që nuk e ka asnjë metër trotuar, si p.sh fshati nga vij unë nuk e ka asnjë metër trotuar të jeni të bindur. Faleminderit!

z.Jakup Demiri: Përshëndetje kryesues, nënkryetar dhe kolegë asambleist! Unë kam pyetje për kryetarin, por në mungesë të tij kërkojë përgjigje nga nënkryetari. Kryetari ka pas premtuar që gjatë mandatit të tij katër vjeçar do të jetësohen edhe katër çerdhe publike në Komunën e Vitisë. Një në qytet, Pozheran, Smirë dhe Sllatinë, dhe tani kërkojë të di se a janë në planë të përmbushet ky premtim I kryetarit. Pyetja ime radhës ka të bëjë më sheshin Project, I cili po jetësohet, debat publike rreth këtij projekti nuk e di nëse ka pasur apo jo, d.m.th projekti po kryhet pa debat publikë, pa ekspert të asaj lëmie të punës,dhe pa debat me kuvendin komunal. Në faqen e komunës nuk kam hasur në informacion lidhur me një vendim që është plan I mobilitetit, që është me 29.03.2016, nuk ka informacion dhe unë nuk e di se ku janë bazuar që kanë filluar punimet për sheshin. Një pyetje e cila është bërë disa herë dhe të cilën po e përsëris për projektin e kanalizimit në fshatin Smirë, i cili nuk ka akoma pranim teknik edhe pse këtë vit është intervenu, ka pasur një intervenim të vogël prej drejtorit të shërbimeve publike, të cilin e përshëndes, sepse një lagje komplet ka qenë e bllokuar, por ka edhe disa telashe tjera. Dëshirojë të di: sa ka kushtu projekti dhe sa pare ka marrë punëkryesi? Faleminderit!

z.Basri Aliu drejtor: Po mendoj që më shumë ka pasur shqetësime sesa pyetje konkrete. Prandaj, unë ju falënderoj të gjithë ju që kontribuat në këtë drejtim. Unë do të mundohem radhazi të ju përgjigjem secilit nga ju për shqetësimet e juaja. Znj.Mirlinda kishte një shqetësim rreth materialit higjenik dhe dezinfektueseve. Është e vërtet që materiali është në përfundim, mirëpo sot mbërrin pjesa tjetër e materialit dhe si rëndomë edhe shpërndahet nëpër shkolla. Shkolla e Goshices dhe e Zhitisë, pyetje e parashtruar nga z.Ali Bajrami. Po i nderuar, mësimi është duke u zhvilluar në këto shkolla sipas vendimit të Ministrisë së Arsimit, e ndarë në kategori A, B dhe C, ndërsa në komunën tonë mësimi është duke u zhvilluar normalisht me të gjitha moshat. Ndërsa, z.Sejda u mundua të përgjigjet rreth shkollës në Goshicë dhe Zhiti. Po i shtoj edhe unë disa informata rreth asaj që u fol më herët. Vendosija e nxemjeve në shkollën e Goshices është projekt për efqiencë, dhe në kuadër të këtij projekti ne kemi pasur edhe kërkesa për shkolla tjera, por që nuk ka qenë e mundur përfshirja e të gjitha kërkesave tona në këtë projekt. Z.Bekim Azizi pyeti rreth shkollës së Pozheranit dhe dihet që është shqetësuese, për shkak të hapësirës është e mangët dhe janë detyruar mësimdhënësit që të gjejnë forma të ndryshme për mbajtjen e mësimit deri në zgjidhjen përfundimtare. Ndërsa sa I përket formës së matjes së temperaturës edhe ne e kemi shprehur si shqetësim, mirëpo ky është vendim I IKSHPK-së, të cilin vendim ne as nuk mundemi ta ndryshojmë e as refuzojmë. Bile unë kam thënë që nuk është matja e temperaturës e nevojshme të secili fëmij, por vetëm në rastet ku dyshohet, mirëpo këto janë vendime të qeverisë dhe neve na mbetet për ti zbatuar. Ndërsa pyetja e parashtruar nga z.Remzi Salihu, për konkurset e sekretarëve të shkollave, është e vërtet që kemi mungesë të sekretarëve në këto dy shkolla, mirëpo arsye e vonës së shpalljes së konkurseve është për shkak të ndryshimit të ligjit i cili është dërguar në gjykatën kushtetuese, mirëpo akoma nuk janë dalë aktet normative për rekrutim dhe si rezultat I kësaj edhe ne jemi vonuar me këtë proces. Faleminderit!

z.Skender Ahmeti drejtor: Faleminderit kryesues, nënkryetar, të nderuar asambleist! Sa i përket pyetjes së shtruar nga z.Bekim Azizi, për asfaltimin e rrugës të pishat në fshatin Terpezë, vend i cili po shfrytëzohet jo vetëm nga banorët e fshatit Terpezë, por edhe më gjerë. Çështja e shqetësimit tuaj është edhe shqetësim i imi zotëri Bekim, edhe për këtë çështje inspektori I mineraleve dhe minierava nga niveli qendror z.Halil Halili ka qenë në vendin e ngjarjes, e ka procedu rastin dhe po besojë që e ka përcjell në instanca tjera gjyqësore. Kam kërkuar edhe në autoritete tjera që të dalin në vendin e ngjarjes dhe të marrin masa. Sa I takon Drejtorisë së Inspektoriatit, masat e kemi marrë dhe janë në procedurë. Faleminderit!

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Faleminderit kryesues, përshëndetje të nderuar asamblist. Janë bërë disa pyetje apo shqetësime nga ana e këshilltarëve komunal dhe unë do të mundohem që t'iu përgjigjem secilit. Sa I përket stacionit të policisë, shqetësim ky I bërë nga ana e këshilltares znj.Mirlinda, ky problem është I të gjithëve edhe pse nuk është në kompetencat tona, ne vazhdojmë të bëjmë përpjekje për te gjetur një zgjidhje, duke bërë kërkesë vazhdimisht në ministri për ndërtimin e një objekti të ri të stacionit policor. Javën e kaluar kam mbajtur një takim onlin më ministrin e bujqësisë dhe njëra nga shqetësimet e mia ka qenë pikërisht mospagesa e dëmeve kundrejt fermerëve dhe krijimi i pikave grumbulluese të qumështit. Gjithashtu u tha që kemi punësuar shumë punëtorë partiak, megjithatë nuk e përjashtojë atë mundësi duke pasur parasysh faktin që ne jemi lokalitet I vogël, të cilët njihemi edhe në bazë të bindjeve politike, por kemi edhe shumë njerëz të tjerë që kemi punësuar nëpër institucione dhe që kanë bindje tjera politike, dhe që ndoshta janë në lidhje gjaku me këshilltarin I cili e ngriti këtë shqetësim. Prandaj them që nuk qëndron ajo se Komuna e Vitisë është e Sokol Halitit dhe e askujt tjetër, Vitia është e qytetarëve të saj. Sa I përket kontributit të qytetarëve për të ndihmuar shkollat, rrugët e tjerat, shqetësim që e ngriti Sejda, them që nuk jeni vetëm ju vendasit e juaj që keni bërë një kontribut të tillë të kësaj natyre, jemi pothuajse të gjithë, sepse edhe fshatrat tjerë kanë kontribu në secilin projekt nëpër lokalitetet e tyre, mirëpo kur jemi te investimet, duhet mu pajtu që dikush mbetet i pari e dikush tjetër I fundit, kështu është natyra e punës dhe si të tillë duhet ta pranojmë. Sa I përket Goshices, në periudhën e qeverisjes së LDK-së unë po besoj që keni akoma punë për tu kryer, vetëm sa I përket investimeve jeni kampion I investimeve nga ana e qeverisë. Sheshi i cili po finalizohet dita ditës, u shtruan pyetje se a ka pasur debat. Ju e dini që sheshi ka filluar në kohë pandemie në të cilën kohë çdo tubim grumbullim I njerëzve ka qenë I ndaluar me ligj. Stadium në Sadovinë dhe fushat e shkollave të shtruara me tepih gome. Me pas mundësi që sot të gjitha shkollat i pajisi më këto tepihë, por megjithatë ne kemi filluar dhe kemi me I pajisur që të gjitha, por kemi bërë përzgjedhjen e këtyre si ndër të parat, pasi që në ato fusha zhvillohen turnire në futboll. Çerdhet si premtim I kryetarit. I nderuar këshilltar, unë kam qenë pjesëmarrës në hartimin e programit qeverisës të kryetarit, s'bashku me disa shokë koleg në vitin 2017, dhe shumë mirë e di që të premtuara kanë qenë dy, ndërsa ju po thuani katër, unë nuk dua ta kontestojë një gjë të tillë, por jam shumë I bindur që kanë qenë dy, një në Viti e cila ekziston dhe tjetra në Pozheran, e cila është në fazën e fundit të implementimit. Sa I përket shqetësimit për shkollën e Pozheranit, më besoni që më sinqeritetin më të madh ju them që është përkushtim I yni dhe I kryetarit, që sa më parë të përfundojnë punimet dhe të jetësohet shkolla. Nuk po them që ne kemi bërë mrekullira, por ju sigurojë që nuk mundet të ekzistojë asnjë problem apo shqetësim I qytetarëve të komunës sonë, I cili nuk bëhet brengë e jona. Kërkojmë dhe bëjmë vazhdimisht përpjekje qoftë në ministri, në institucione tjera përkatëse për të bërë zgjidhje për problemet e qytetarëve. Faleminderit!

z.Taulant Haxhiu: I nderuari nënkryetar Aliu, familja Haxhiu, Kajolli është familje e madhe dhe kanë bindje të ndryshme politike. Shefi I kabinetit kryetarit është I familjes Haxhiu, gjithashtu e keni punësuar në punë një familjar tonin për hirë të asaj që është fëmij I dëshmorit, I cili ka flijuar veten për lirinë e vendit. Kurse sa I përket punësimeve tuaja familjare, ju keni punësuar djalin e juaj në "Hidromoravë", kurse vajzën e vëllaut e keni punësuar në arsim.

z.Mirlinda Sadiku: Sa I përket punësimeve, kur po thuani që keni punësuar një të lëvizjes, kjo nuk qëndron fare, sepse kemi raste kur as nuk I keni ftuar në intervistë e lëre më t'iu punësoni. Sa I përket stacionit policor, nënkryetar, kur e keni mbajtur një mbledhje emergjente për Covid-19, atë ditë ka qenë në vizitë zëvendësministri I asaj kohe të qeveris, z.Bajram Gecaj. Unë po kërkojë të dijë nëse ka diçka konkrete rreth kësaj çështje, jo vetëm fjalë e premtime.

z.Sejdi Emiri: Faleminderit kryesues! Së pari e kam edhe një kërkesë të cilën nuk munda më herët ta bëjë. Nëse më lejohet. Kërkesa ka të bëjë për disa persona të cilët janë në trajtim të hemodializes, është nevojë urgjente që të iu mundësohet trajtimi në Viti. Nënkryetar, u mundove disi me i relativizu gjërat. Unë asgjë nuk thashë më shumë, përpos atë që e bënë një dallim të madh në investimin e qeverisë dhe investimin e qytetarëve tonë. Duke e ditur që qytetarët e tonë paguajnë kontribute, tatime, që ato kontribute dhe tatime t'iu kthehen në investime kapitale. Asnjëherë nënkryetar nuk të kam kundërshtuar sa I përket fshatit Remnik, shumë respekt për qytetarët e Remnikut,

mirëpo kisha pas dëshirë që edhe ti mi respektu qytetarët e fshatit tim ose cilit do lokalitet në Komunën e Vitisë. Faleminderit!

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Taulant, unë e njohë familjen Haxhiu dhe shumë respekt. Sa i përket punësimeve familjare, përpos atyre që I ceke ti, unë kam dhe vëllaun që punon në komunë dhe një tjetër që ka një kompani private dhe madje shumë është I fortë. Dhe këta të cilët ti po thu që janë punësuar në kurriz timin e ke shumë gabim, mundesh me pyt dhe me kuptu që ata janë merituar në atë vend ku punojnë, sepse janë të shkolluar dhe janë të përkushtuar në profesionet e tyre. Po ta shkjarojë më thjeshtë, që ti ta kuptosh më mirë, që ata kanë qenë të vetmit të merituar në vendet e punës në të cilin punojnë sot dhe për këtë të ftojë të marrësh informata dhe të bindesh, dhe atëherë do ta kuptosh që njerëzit e tillë është dëshirë e sicitit vend të punës t'i mbaj afër dhe t'i punësoj. Unë I nderuar qe 6 vite punojë këtu dhe asnjëherë nuk kamë përmendur emra të njerëzve se kush dhe ku është punësuar, nuk është ky roli I këshilltarit, roli yt duhet me qenë orientimi I politikave zhvillimore. Nëse ti po mendon që këto punësime janë bërë në kurriz timin, të lutem ndjeki mundësitë ligjore për ankesa dhe mos u merr më gojëdhëna, sepse s'shtë në rolin tënd një gjë e tillë. Faleminderit!

z.Taulant Haxhiu: I nderuari nënkryetar, unë nuk thashë që i mungon djalit tanë e qikës se vëllaut tan profesionit, apo nuk është adekuat për atë vend, po ti e ceke që dy ose tre familjar të mi që janë të punësuar në komunë, ata janë familjar të mi, nuk e mohoj asnjëherë, po se qysh i ki punësuar ti ata e dimi të gjithë, po unë edhe njëherë po e ceku, se asnjë pushtet as pushtetit i PDK-së nuk ka pas kësi punësime 100% punësime të LDK-së.

znj.Mirlinda Sadiku: Qysh deklarohem unë, është çështje personale, se ai zotnia me qiti subjektiv, u bë që e rrezoj qeverinë për at individ. Nënkryetar, nuk është e drejtë, se kogjo shumë ki përdor kualifikime të ndryshme. Ka qenë një kohë e protestave, ku zotri Bislimi është arrestu, ka shku në burg, e ki pas dhanë një kualifikim kogjo të ranë. Sa i përket punësimeve, ato janë fakt, me trego si jurist që jeni, si ka mundësi në një konkurs pune të anashkalohet një individ e cili ka 10 vite provoj pune, i ka të gjitha trajnimet, i ka korrikulën, ju e dini shumë mirë se për kanë po flasë, e kam thanë edhe seancën e kalume, që asaj grue ju kanë shkel të drejtat elementare, ndërsa zonja në fjalë, me gjithë respektin, është pjese e familjes së juaj, po ti vet e thave se mundeni me qenë subjektiv në këtë rast ki qenë shume subjektiv, sepse janë shkel të drejtat në konkurs, kriteret me të dy kamtë. 10 vite provoj pune, të gjitha trajnimet, shume herë u shpall mësuesja më e mirë se ku ka punu me herët këtu, pse nuk e ka librezën partiake, plus e ka publiku në fejsbuk që e ka mbush testin 100,% për këtë rast kam thanë.

znj.Hanife Januzi, drejtoresh: Faleminderit kryesues, përshëndetej të nderuar të pranishëm! Sa i perke pyetjes së menaxhimit të situatës së pandemisë, besoj që është menagju në formën me të mire të mundshme, prej fillimit e deri me sot, edhe pse nuk kam qenë dëshmitare e asaj suate fizikisht, besoj që jemi dëshmitar të gjithë, se vërtet ka qenë menaxhimi më i mirë që besoj që ka qenë si një shembull. Sa i përket rasteve të infektuara, i kemi 19 raste, 357 i kemi raste pozitive, situata është e menagjushme, e mire, kemi marr të gjithat preventivat që janë të domosdoshëm për menaxhimin e situatës, edhe pse po flitet që do ta kemi edhe një valë të tretë të pandemisë, mirëpo i kemi ndërmarr të gjitha veprimet e duhura. Numri i të vdekurve është 23. Sa i përket pyetjes së Bekimit, i kemi 43 të punësuar me KARITAS, mirëpo na duhen ende punëtor, kemi bë kërkesë dhe në Ministrin e Financave, që të bëhet dhe të punësohen edhe disa mjek e infermier, mirëpo Ministria e Financave e ka kthy përgjigjen negative, për arsye që nuk e kemi në plan program të Ministrisë se Financave, kështu që kemi ende nevojë për infermier dhe doktor.

z.Hasan Aliu, nënkryetar: Po me vjen keq këshilltare që po i përzien, edhe ti po tmerrohesh. Unë tmerrimin tan sun e heku, ti ndoshta tmerrohesh edhe ka të me pash si genie fizike, megjithatë unë nuk besoj që kam bë veprim që e tmerroj dikan, se me pas tmerru do të ish në burg dhe kurrë mos përdor emra shume larg meje, edhe 50 vjet me ti dhanë ymër, se nuk du me i thanë të mirat dhe sakrificat e mija, pikërisht për ata që e përmende, është keq. Unë kurr nuk jam thirr në individualitet, obligim i të gjithëve atyre, konsideroj që e kanë bë për shokë, për kohen të cilën e kemi kalu, prandaj ma të lutem.

Kryesuesi z.Naim Pira: Ju faleminderit të gjithëve! Tani po kalojmë tek rendi i ditës.

R e n d d i t e

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendi Komunal.
b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës 12.03.2020.
c) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja urgjente e datës 31.03.2020.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2021-2023.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoha për vitin 2021.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore në pronën e paluajtshme për vitin 2021.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët në komunës së Vitisë.
6. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit nr.01-110/05-764 për plotësim ndryshim e vendimit Nr.01-110/05-370, të datës. 08.05.2020 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulancës shëndetësore në Terpezë .
7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr.01-110/05-546 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale NPSH “Arena Sport” në Kabash.
8. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për krijimin e qasjes së parcelës Nr. 3760-0, në rrugën publike me nr.2592-11, përmes parcelës me nr.2582-6 dhe nr.2582-8.
9. Propozim vendim për miratimin e planit të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2021.
10. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirin e znj.Hazire Gjela, anëtare e Komiteti për Komunitete në Komunën e Vitisë.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush rrethe rendit të ditës ju lutëm?

z.Hasan Aliu nënkryetar: E kemi propozim vendimin për themelimin e vendgjuetisë së përbashkët në Komunën e Vitisë. Drejtoresha e ka sjell vendimin, po pasi që kërkohet një leje nga ana e Ministrisë së Bujqësisë, megjithatë ka kalua afati dhe ata nuk e kanë sjell përgjigjen, andaj që mos të kemi problem që të shpallin vendimi të kundërligjshëm. Me mirëkuptimin e juaj, kërkoj që këtë pikë ta terjekim nga rendi i ditës, përderisa nuk na ka ardh materiali prej Prishtinës që ta kompletojmë këtë lëndë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Me propozimin e nënkryetarit, që të tërheket kjo pikë nga rendi i ditës, unë e qes në votim për miratimin e rendin të ditës. Nga të gjithë të pranishmi u miratu rendi i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. a) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendi Komunal
- b) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e datës 12.03.2020
- c) Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja urgjente e datës 31.03.2020

Kryesuesi z.Naim Pira: Dëshiroj të ju njoftoj, se procesverbalin nga mbledhja e pestë e kemi të mangut, për fakti që aparatit që e ka bërë ingjizimin, nuk dëgjohet mirë. Në jutube e keni imgjizimin. Unë kërkoj mirëkuptimin e juaj, që të miratohet kështu. Pasi që nuk ka vërejtje rreth procesverbaleve, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratuan procesverbalet.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për projekt buxhetin e Komunës së Vitisë 2021-2023

z.Ibrahim Rama drejtor: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Para juve është projekt buxheti i komunës së Vitisë për vitin 2021-2023. Të nderuar këshilltar komunal, pra është një dokument të gjithë e konsiderojmë që është një nder vendimet me kryesore që i kerr kuvendi komunal, që ka të bej me dokumentet që i paraqet ekzekutivi, gjegjësisht qeveria në raport me punën dhe aktivitetet e saj. Pra, është buxheti i propozuar nga kryetari i Komunës së Vitisë, i përgatitur nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, gjithnjë duke u bazuar në nenin 58 të Ligji

mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe dispozitat e tjera pozitive që kanë të bëjnë me këtë. Është një proces mjaft i komplikuar dhe merr kohe gjate hartimit, duke filluar afërsisht ka mesi i muajit maj, pra si projektion fillon dhe përfundon deri me 30 shtator duhet të miratohet dhe kuvendet komunale dhe të behet një ligj. Jemi mundu, nuk është hera e parë që po e propozoj projekt buxhetin të tillë para kuvendit komunal. Qarkoret këtë vit i kemi pas tri, një më shume se vitet tjera. Kjo ka ndodhe për hir të situatës së përgjithshme që ka të bëjë në Kosovë dhe në të gjithë boten me pandeminë Kovid 19 dhe kështu që me qarkoren e parë dhe me qarkoren e dytë kemi pas një strukturë të propozuar të buxhetit, që janë parapa të gjitha të hyrat e buxhetit komunal dhe struktura e brendshme e shpërndara sipas kategorive ekonomike, kurse me qarkoren e tretë na është propozuar gjithmonë në bazë të projeksioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me projeksionet makroekonomike që parashihen të ndodhin në vitin 2021 dhe ne vazhdim kemi pas një zbritje të buxhetit prej 285 mije euro, 198 mije është planifikua zbritje me pas në grandin e përgjithshëm në mjetet financiare që derdhen nga niveli qendror dhe 90 e diçka mije euro është zvogëlim i planifikimit të të hyrave vetanake, që duhet t'i grumbulloj Komuna e Vitisë për vitin 2021. Në këtë drejtim korniza e fundit që është ardh e planifikuar, që buxheti i Komunës se Vitisë të llogaritet në mjetet e përgjithshme financiare, në vlerë nominale prej 12,490,686€. Ky buxhet financohet u hyrat vetanake gjegjesish doket kesht e nivelit qendror dhe 6.9%nga të grandet nga 93.10%nga **11,629,436** e financon niveli qendror buxhetin, kurse 861,250€ janë të hyra vetanake që e plotësojnë buxhetin e Komunës së Vitisë. Kjo është struktura që ka të bëjë me buxhetin për vitin 2021. Materialin e keni marr me kohë, për pyetje dhe sqarime jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pik të rendit të ditës.

znj. Mirlinda Sadiku: Drejtori e tha atë dhe e argumentoj, që në momentin që i bani votat bash hiq nuk niti për kërkesat e LVV-së. LVV-ja qyshe në kornizën afatmesme buxhetore, nëpërmjet përfaqësuesit tanë në KPF, shumë mirë, shumë kuart i ka thanë kërkesat tona, që nuk janë kërkesa vetëm si subjekt politik, po në fakt janë kërkesa të qytetarëve, se edhe ne përfaqësojmë qytetarët. Po sa i përket dëgjimeve buxhetore, ani pse u kanë kohë pandemie, nuk është që nuk keni pas kohe të mjaftuar, se keni mund te kontaktoni shefat e grupeve ashtu siç kanë vepru shumë komuna nape Kosovë ose keni muj me e shfrytëzu aplikacionet onlin zum, me i thirr shefat dhe me i diskutu kërkesat e tyre, po në momentin që i bëni votat, bash hiq nuk jav nin se çka është tu than grupi i LVV-së. Edhe për këtë arsye ne i kemi edhe kërkesat që sot i përsëris prapë. Një pyetje e kam drejtor. Për shtat vite asnjë politik të re nuk e ki bë buxhetore, ama asnjë. Krejt çka kemi ndëgju është asfalt e zhavorr, infrastrukturë. Projektioni i rritjes së buxhetit, nëse shikon vitin e kaluar, e kam këtu, projektioni ka qenë me pas rritje 3.45.,% ndërsa këtë vite është edhe media, ka qenë që rritet buxheti i Komunës së Vitisë. Po këtu është një kalkulim me shifra është vetëm 1.5. Pse po ndodhe kjo? Megjithatë duhet të jemi real, sepse sipas asaj që e tha ministrja, minus 300 milion euro mungojnë në arkën e shtetit, kur të ja shtojmë edhe inkasimin e tatimit në pronë, që jemi minus, shume diskutabile është që do të kemi edhe këtë shume buxhetore. Uroj të jem gabim. Nëse e shikon si buxhet në tërësi, enkas është i dedikuar për asfalt, zhavorr, është vit elektorale. Ju duhet me pre shirita dhe me bë foto, po megjithatë kur thave që është për qytetar, është mirë me ditë, se sipas vlerësimit të performances nga MAPL-ja, Vitia nuk qëndron mire me ujë të pijshëm. 39.93% jeni vleresu, bile bile jeni në rangun e fundit të të gjithë komunave, se ndoshta koleget nuk e kanë këshyr, si dokument është i publikuar në Gusht të vitit 2020, po ashtu njëjtë qëndroni edhe me kanalizimet, mirëpo ne si LVV nuk eshët që bëjmë vetëm fjalë, kemi ofru kërkesa konkrete dhe jo me shku si vitin e kaluar që mos mi përkrash kërkesat tona. 1. Investim 100 mije euro për fabrikën në Letnicë, rritja e kapacitetit. Nëse vlerësimi i performances nga MAPL-ja ka qenë për ujë të pijshëm, na po dojmë me pa në buxhet, jo vetëm 30 mije euro qe janë parapa vetëm për filtera. 2. Keni pagu pagat jubilarë tek shëndetësia, se keni pas suficit, po te arsimit keni mbete borxh. Mu ma merr mendja, që ne si qytetar të kësaj komune jemi ni të diskriminuar, pse duhet t'i marr shëndetësia e arsimit jo. LVV-ja propozon, uroj që doktoresha Gjyle ta mbështes këtë 120 euro për grat lehona. Që nga vitit 2015 e kërkoj gjithmonë. Fjala e kryetarit u kanë, do t'i shikoj, do t'i shikoj mundësit buxhetore. Ju lutem, jemi në vitin 2020, po flasim për buxhetin e vitit 2021, që gjashtë vite kurrë nuk gjete hapësirë buxhetore. Gjitha jonë të llogaritura me kosto, nëse të duhet i kemi. Shujta për fëmij nga niveli 1-5. Edhe kjo e ka koston. Çerdhe publike, po ashtu në raport vetëm 4% te fëmijve janë të perfshirë në institucione parashkollore, në çerdhe. Nivel jashtëzakonisht i ultë, çdo fëmij ka të drejtë, sepse ndikon në zhvillimin e tij psikofizik. Ju e thatë një arsye, që nuk ju ka leju ministria. Kërkoj që 900 mijë erthin, që 90% e dërgut ne investime kapitale. Kërkoj blerjen e maskave dhe dezinfektuesve, d.m.th vij buxhetore të veçantë për fëmijët në shkolla. Unë vij nga fusha e arsimit, ka shumë nxënës që nuk kanë mundësi me ble, ka shumë nxënës që i dëmtohet dhe shume herë kërkojnë nga ne, që t'i japim maska. Ka njëherë kemi, po ka

njëherë nuk ka. Kërkesa nr. 7. një fond për personat me aftësi të kufizuar, një nder kategoritë që është neglizhu nga kjo qeverisje, e kemi pas një raport këtu në kuvend, ku shume kjart u thanë që asnjë eskurzion nuk e keni subvencionu. Është mjerim ose me i vizitu këta me ju ble karroca ose kanë nevoja të ndryshme. D.m.th, nuk është fond i madh që mundet me pas që çrregullim buxhetor. Kërkesa nr. 8, është rritja e fondit të bursave për student. Mjerim që një vit e keni shpall konkursin edhe hala nuk janë nda bursat. Gjynah! Diçka që keni pas në buxhet që një vit, ata presin për qato bursa. Rritje të subvencioneve, drejtor, na emërto një investim kapital në bujqësi, thuna një. Kërkesa nr. 10. Është një mini treg i gjelbër tek rruga “5 Maji”, në anksin rrugor Radivojc-Skifteraj-Gjilan. Kërkesa nr. 11, Ndërtimi i sallës së edukimit fizik tek gjimnazi. 12. Rivitalizim i shkollës ne Qifllak, adaptim për çerdhe. 13. Fond emergjent nuk keni parapa, jemi në kohën e pandemisë. Kjo pandemi është nis, po nuk dijet ku po përfundon. 14. Sa subvencione do të ndahen për biznese dhe viktimat e dhunës në familje, sa buxhet do të këtë për program të rintegritit të tyre, se na keni pru një strategji, po është mire të përcjellët edhe në buxhet. 15. Ndarja e shumes 500 euro për familjaret të cilët kanë humbur me të dashurit e tyre nga Kovid 19, 28 viktima nga 500 euro kosto 14000 euro. Plani zhvillimor komunal i arsimit kurrë nuk u sjell ne kuvend, edhe pse e keni obligim ligjor, edhe unë nuk e di sa janë adresu kjart dhe qartë çështjet e arsimit, ku ka shkollat profesionale kanë shume më të mëdhaja nevojë për punë profesionale të nxënësve. Këto janë kërkesat tona dhe po ju thamë në fund, nëse nuk merren parasysh, ne si LVV votojmë kundër, nëse merren parasysh do të bëjmë përjashtim dhe do ta votojmë. Na trego drejtor, t’i qesim në votim kryesues dhe të shofim apo i merrni parasysh.

z.Bekim Azizi: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Kjo pika me e rëndësishme për të cilën pikë jemi të obliguar që ta japim kontributin dhe ta orientojmë sa më drejtë dhe ta shfrytëzojmë sa më drejtë. E dimë që shpeshherë kemi pas vërejtje ne orientim, e sa i përket shfrytëzimit, mos të flasim, se po shifet se çka jeni tu bë, mirëpo bazuar në këtë projekt buxhet që e kemi para veti, kemi dhënë një pjese të vërejtjeve edhe në KPF, e kemi diskutu mjaft shumë edhe me drejtorin. Unë mendoj që çështja me e rëndësishme është dashtë të jet sot është, tu e ditë që pandemia është një diçka që do të zgjat. Bazë të gjithë analistave që e thonj dhe vala tjetër parashifet që deri në vitin 2020-2021 të jet vit që do të përballemi me ta. Unë mendoj që është dashtë ti kushtojmë rëndësi më shume dhe këtë pjese nuk kemi nda mjete ose nuk kemi parapa deri me tani. Për rritjen e mjeteve tek shërbime dhe mallra, tek shëndetësia dhe në arsim. Në shëndetësi tregon që ki bë rritje, në arsim nuk ka ndonjë rritje, mendoj që do të jete sfida më e madhe arsimit, sepse funksionimi i shkollave do të jete shume i kushtueshëm me gjendjen që jemi duke e mbajt me pandemi që do të vjen. Unë medoj që këtu është dash të kemi një rendësi me të madhe t’i kushtohet, sepse dy sfidat kryesore që do të jenë, arsimit dhe shëndetësia, që do të na përcjellin këtë vit. Unë mendoj që nuk po shof që janë dhënë tema. Unë e di që ndarja ne shkolla behet bazë numrit të nxënësve baze disa kriterëve që janë, mirëpo mendoj që ka qenë e rëndësishme të jetë një shume më e madhe, sepse me të vërtet kërkon shume shpenzim. Është numri i madh i njerëzve që gravitojnë nëpër shkolla, sepse nëse na ndodh që na përsëritet pandemia, edhe në shkolla të rritet numri, të vazhdojna me procese të mësimin online, të dini se na veç jemi tu e fundos arsimit beson që sa kurgja hiq, na duhet mu mundu me çdo kusht që mos me kalu në sistemin online. Problemet që janë paraqit çdoherë tek shpenzimet kapitale, që janë disku orientimi i shpenzimeve kapitale, përherë drejtor na kanë ardh të njëjta. Na premtove që sot në seancë do të naj prush disa projekte që janë të përgjithshme në forma më të thjeshtuara, se ku do të shkojnë ato pjese të investimeve, po nuk na kanë ardh sot dhe me këtë pjesë unë mendoj që nuk ka këshilltar këtu që sot e qon gishtin për këtë buxhet dhe që e dinë se çka ka mu bë. Nuk mendoj që ka këshilltar këtu që e dinë, p.sh.: asfaltim i rrugës rurale. Cilat rrugë janë?, sepse nuk kemi as një shënim. Nuk besoj që dikush prej këshilltarëve që do ta dimi se cili është rregullim i rrugëve me zhavorr, cilat rrugë do të rregullohen. Gjithherë kemi kerku, që t’i definoni këto, që se paku ta dimë edhe na, se për çka po votojmë. Unë mendoj që kësaj radhe u dashtë mirëmbajtja e varrezave. Na e dimë që te varrezat është kanë mirë të jete një kod i veçantë, që janë një pjese e varrezave, sidomos do varreza të vjetra. Unë mendoj që është dashtë të jete një kod për rregullimin ose meremetimin e shkollës se vjetër tek shkolla teknike që janë punëtoritë, ku janë aty 7 punëtori, 16 klasë, i kryen praktikën 16 klasë në jave, aty i mbajnë prej 6 ore deri në 12 ore dhe aty nuk ka askush kusht elementar që i ftoj edhe mediat me ardh me pa. E bëjmë një vizitë, e shofim çka ka, as nuk ka dritare, as nuk ka ujë, as nuk ka banjo, asnjë element aty nuk është që munden me nejt e me punu dikush. Duhet me nda një kod për ata që te merremetojnë, të rregullojnë të mos pikë, të ketë dritare, të ketë ujë, banjo etj. Nuk kemi parapa, e që unë mendoj pjesë e shëndetit është edhe sallat sportive. Nuk jemi tu parapa asnjëherë në buxhet, është mirë do shkolla me fillu me do shkolla me të mëdhaja. E di që është buxhet i madh, mirëpo të parashohim një pjesë nuk kemi parapa asnjë rezervë tek zbatimi i kontratës kolektive, që është tu na kushtu çdo vit. Gjykata naj merr ka 100 mije euro, ne e dimë që tash është vala e madhe e

mësimdhënësve, që kane bërë të gjithë padi në gjykatë për zbatimin e kontratës kolektive, që bazë të dhënave që i kanë nga sindikata, do të jetë një vlerë ndoshta 2 milion euro. E kame pas propozim edhe atë ditë, kur është bërë ridestini i mjeteve edhe tash, mirëpo prapë nuk po kemi një kod që të leni rezervë, që mos të na dëmton projektet, sepse ata kur po hinë me gjykatë e me përmbarus, po rritet vlera. Nuk kemi parapa kurgja tek rimëkëmbja ekonomike. Na e dimë që pritet ligji me kalu në kuvend, e që do të jete një ndihmesë e madhe, po këtu në buxhetin tonë, jemi pjese lokale. Po e dimi që Viti përherë është e anashkalume prej nivelit qendror, mirëpo unë mendoj që ka pas mundësi që ti shtimi do kode më shume tek subvencionet. E pash që në bujqësi ka rritje, që është e mirë, po tek shërbimet sociale 38 mije euro naj ka përsërit që sa vite. Unë mendoj që edhe aty është një kategori që ka kërkesa mjaft shumë, ndoshta ka qenë e rëndësishme që edhe aty të jetë një ngritje sikur ka qenë tek bujqësia. Kam edhe vërejtje tjera, po më konkrete ishin këto. Unë mendoj që buxheti duhet të jetë shume i specifikuar, kështu si e keni sjell nuk na mush sy si shabllon keni shku, sikur vitet tjera.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar koleg! U ceken, u thanë shumë nga parafolësit, ato çka u thanë nuk po ti thamë. E dimë që buxheti financohen nga grandit qeveritar dhe të hyrat vetanake, pagat vinë nga grandit qeveritar dhe mallrat dhe shërbimet. Ajo që vlen të ceket, kemi rritje të subvencioneve në vlerë 350 mije euro. Dhe tjetra, çka është me rëndësi tek projektet e investimeve kapitale, që është në vlerë prej 2 milion e 464 mije euro. Grandit qeveritar është 11 milion e 629 mije euro dhe të hyrat vetanake 861 mije euro t'i rrumbullakoj shifrat, mos të hinë tek këto që janë me vlerë më të vogël. Totali është 12 milion e 419 mije euro. Kisha pas dëshirë që të hyrat vetanake t'i kemi jo në nivelin e vitit të kaluar, po më shumë se janë direkt të hyra që i kthehen dhe hynë në shërbime të komunës dhe qytetarëve të Komunës së Vitisë. Dimë, janë tu ndiku shumë faktor, kemi ramje edhe të hyrave nga dogana, edhe nga administrata tatimore, që si çashtje që ndikon pandemia. Një sfidë që është e kushtueshme, por duhet të jepet maksimumi, të behet menaxhimi sa më i mirë, edhe pse kushton po duhet ta mbrojmë popullatën. Rritjen e investimeve kapitale. Nëse e marrim 2020, që ka qenë 1 milion e 660 mije euro, sivjet kemi një shumë prej 2 milion e 464 mije euro ose në vlerë nominale të parasë, 804 mije euro. Vota po e këtij projekt buxheti është një votë për progres, për infrastrukturë më të mirë, ujësjellës, arsim, shëndetësi, kanalizim e trotuare. Vota kundër e kësaj është regres, prandaj ne si grup parlamentar i LDK-së, do ta mbështesim dhe do ta votojmë këtë plan buxhet për vitin 2021.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Struktura e projekt buxhetit 2021 dhe projeksionet për vitin 2022-2023, unë kam një shqetësim kogjo të madh. Po e filloj nga uji. Alia tha që vota kudër për këtë projekt buxhet është votë e regresit, po me këtë projekt buxhet nuk ki hiq ujësjellës. Vitin e kaluar kam qenë me një trajnim dhe ka pas pyetje, e ku janë përgjigj që është gabim dhe nuk guxon të votohet buxheti pa u specifiku investimet kapitale. Qytetari ka të drejtë dhe duhet të jetë në dijen, se ku shpenzohet paraja e tij. Me këtë projekt buxhet, qytetarët nuk e dinë se ku investohet. Tek ndriçimet publike, vlera për vitin 2021 është 370 mije euro, ndërsa projeksionet për vitin 2020-2023 e kapin vlerën 1 milion e 50 mije euro, ndërsa tek ujësjellësi nuk keni asnjë cent, përveç këtyre 30 mije euro. Unë mendoj që në projekt buxhet duhet të kemi të ndara para për ujë të pijes. Tek asfaltimi i rrugëve rurale, edhe këtu duhet mu specifiku, drejtori më ka premtu që ka me sjellë, po nuk i ka sjellë. Rregullimi i rrugëve me zhavorr. As këto nuk e dimë se ka kanë mu investu. Vlera e cila është 208 mije euro këtë vit e për dy vitet tjera është afër 1 milion euro.

z.Ali Bajrami: Plan buxhetin e kam lexu. Dëshmi janë shifrat që e përmenda mënyra e votimit. Në këtë mënyrë kemi qenë në trajnime. Unë personalisht kam qenë nja katër pesë herë. Pyetja që është shtrua ka qenë, a mundet plan buxheti me u votu pa specifiku, ka thanë që mundet, se sikur që mos mundet me u votu, në këtë mënyrë MAPL-ja kishte me kthy.

z.Jakup Demiri: Trajnimi ka qenë vitin e kaluar në Gjilan, ku specifikisht ka thanë që nuk mundet të votohet një projekt buxhet, ku investimet kapitale nuk janë të specifikuar në projekte me data.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket pikës në të cilën po diskutojmë, është një pikë me e rëndësishme. Pajtohem me drejtorin që tha, buxheti i dedikohet qytetarit, po është mirë që me ju dediku në mënyrë proporcionale, pa bërë diskriminime. Kam pa që disa trotuare janë bërë në disa fshatra, në dy anët ka ndriçime në proporcion në disa fshatra më shume së vet qytetin e Vitisë. Tash qyteti i Vitisë është fshati më i madh që e quajmë qytet me i urbanizuar. Unë mendoj që fokusimi i investimeve duhet mu kanë pak më i madh në Viti, se kemi në qytet të Vitisë nevojë për shumë kanalizim, me bërë ende trotuare ende andaj. Ju kisha lut mu fukusu pak me shume në 2021-2022-2023 në Viti. Sugjerimi i im është, që tek mallrat dhe shërbimet dhe shpenzimet komunale me bërë restruksion pak në mënyrë që mu rrit shpenzimet në investime kapitale. Pse po e thamë shpesh, e shoh në

raport financiar këtu, blihen kompjutera, përsëriten shpesh, mobile shpesh blihen. Normal që duhet pak me qenë edhe kursimtar. Unë personalisht e kam një karrige, ku punoj që 15 vite, besoni edhe një kompjuter e kame prej 2011. Tash me kalimin e kohës ai amortizohet. Na e dimë që mallrat dhe shërbimet janë shpenzime për mirëmbajtje të pasurisë ekzistuese dhe me ju shërbye qytetarëve pak më mirë, mirëpo kur e shof vlerën që mundet me kap në 2023, 2 milion euro për Komunën e Vitisë, është vlerë shumë e madhe. Shpenzimet kapitale, 1 milion e 660 mijë për vitin 2020. Në votimin që e kemi bë 985 mijë euro, a rriten këto tash, apo kthehen këto mjete. A është qeky vlerë 1 milion e 660 mijë për investime kapitale, për vitin 2020, apo me kthimin e mjeteve që naj kanë marr për paga, a rritet tash kjo vlerë, me duket që rritet kjo vlerë. Këto mjetet që i kemi kthy në seancën e jashtëzakonshme, është mirë më qenë më azhurshëm, se ka mundësi munden me na tepru, se jemi shumë vonë. Tek projektet investive publike, që na në shqyrtim i kemi 2021-2023, realisht edhe ligjet në fuqi edhe rregullore e japin, që klasifikimi i projekteve duhet mu bë në mënyrë të saktë. Këtë e dinë krejt, edhe unë ku punoj, kemi buxhet, dhe asnjëherë buxhetin nuk e votojmë, as bordi nuk e voton pa e përcaktu se cili projekt, kur ka me ndodh, në cilin vit saktësisht, lokacioni, mirëpo nëse e kalon MAPL-ja, kështu unë po jam i befashuar. Kam një pyetje tek projekti i investimeve publike për vitin 2021. Kur i kthjem këto mjetet që naj pat marr qeveria, asfaltim i rrugës në fshatin Smirë – Kurlishtë dhe Terpezë, na më herët e përmendem që këtë vit ka mundësi mu shtru rrugë për Kurlishtë. Tash nuk e di a ka mu shtru në 2020 apo në 2021, apo është projekt dyvjeçar. Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimet publike, 370 mijë euro, vlerë e madhe. Kjo këtu duhet me bë restruksion dhe me distenu mjete më shume për rregullimin e kanalizimit. Edhe shumë pare po ndahen për zhavorr, e zhavorri edhe ashtu kushton lirë, 300 mijë euro me i nda për zhavorr shume po me doket këtu. Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik, 370 mijë euro. Të keni parasysh, se te rruga “Dëshmoret e Kombit”, që po bëhet vërshim, edhe një trotuar duhet mu bë nga ana e majtë në drejtim të pazarit të gjelbër. Kur është investu, aty u fut një gyp atmosferik fi 200, që me kohe ju kam terjek vërejtjen, ju kam thanë, që ky është shumë i vogël, gyp fi 200. Tash naper shtëpi fusin njerëzit, aty të ndahet një pjesë e mjeteve, aty me bë një gyp atmosferik plus trotuari. Tek fusha e Sadovines se Jerlive, fusha sintetike, aty të ndahen pare për kubza dhe tualete, kishin nevojë për këto. Duhet me parapa tek pritja e udhëtarëve, tek rruga e Skifteraj, duhet me bë një vend pritje me kulm për qytetar.

z.Taulant Haxhiu: Për këtë projekt buxhet. Unë vi nga bizneset, krejt çka i tha kryetari i partisë sime pajtohem me ta. Unë e kam një kërkesë. Na e dimi që sidomos sektori i gastronomisë është me një kollaps të madh. Shumica e restoranteve, kafiterive, bizneseve të vogla, janë para shuarjes. Çdo biznes i vogël ka 5 -10 punëtor. Unë gjatë bisedës me ta, shumica prej tyre dojnë edhe t'i mbyllin bizneset e tyre, sepse nuk po kanë punë. Disa biznese mendojnë sot shumë seriozisht t'i mbyllin bizneset, dhe mendojnë që të dalin jashtë në mërgim. A keni menduar që ti ndani së paku 100 mijë euro për bizneset në Viti, të cilët kane nevojë që të ju kthehen normalitetit. Nëse na kishim pas një buxhet të ndarë për ta, ata ishin rikëmbë, ishin kthy normalitetit dhe besoj që ekonomia ish kanë në gjendje të mirë. Një komunë që nuk ka ekonomi të shëndosh, është si fëmijë pa bereqet. Pasi që vi nga biznese, nëse ti ki vullnet që këtë propozimin tim ta merr, t'i ndajsh 100 mijë euro për bizneset, unë do të votoj, besoj që edhe grupi parlamentar do ta voton.

z.Hasan Aliu nënkryetar: Duke ju falënderuar të gjithëve që kontributin e dhënë, pa dash me kontestu asnjë prej atyre të cilët dojnë t'i shtojnë buxhetin, se të gjitha kanë nevojë, po megjithatë duhet të shikohet mundësi sa i kemi. Do t'u përgjigjem në disa pyetje, te tjerat përgjigjet drejtori. Nuk muj mu pajtu që u tha për 7 vite asnjë freskim, po të njëjtat kompetencat e këshilltarëve komunal të komunës, janë 19 pika më Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, të përsëritshme, nuk dyshojnë, duhet me i zbatu qato 39.93 me ujë të pijshëm pajtohem plotësisht bile unë e kam trjatu me pak se 39.93 në takimet që i kamë pas ata konsideroj që e kane fry këtë shifër për mendimi tim 39.93 qytetarët e Vitisë nuk kanë ujë më pak është kjo shifër. Propozimi i juaj prej 100 mijë euro fabrikës së ujit, i joni ku janë të ndara 370 mijë, që dje kam qenë pjesëmarrës i takimit, ministrit Kuqi, Kryetari i Komunës së Vitisë i propozon në të cilën pritet një nënshkrim i marrëveshjes së mirëkuptimit, se Komuna e Vitisë është në gjendje deri në 300 mijë euro me nënshkru një marrëveshje të mirëkuptimi në mes të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe ambientit ne mese të “Hidromoraves”, që Komuna e Vitisë deri në 300 mijë euro participim me kusht që të gjithë qytetarët e Komunës së Vitisë të kenë ujë të pijshëm dhe kapaciteti i fabrikës së ujit në Letnicë propozohet nga ana jonë, që të ketë 120 litra për sekondë, sa do të arrim këtë nuk varet krejt prej neve, ju e dini që edhe CDI-ja qe vepron janë pare të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Ajo është, haset e “Hidromoraves”, e kam thanë edhe njëherë, por gatishmëria jonë edhe e juaja është që të bëjmë çmos njëherë e përgjithmonë ta heqim këtë problematikë nga koka, d.m.th përputhmi me këtë çështje. Ju keni dal me 100 mijë, na jemi për më shumë, sepse

nuk behet zgjidhje me 100 mijë. Kërkesë për personat me nevoja të veçanta. Na jemi tu ju ndihmu në vazhdimësi, më shumë simbolike. Ju kam thanë njëherë, që ekziston një rregullore e cila ka ardh nga niveli qendror dhe të gjithë ata që veprojnë si shoqata, duhet të konkurrojnë, ku del thirrja nga komuna me programet e tyre dhe varësisht nga programet të cilët i kam behet edhe ndarja fatkeqësisht, që nuk kanë konkuru dhe na kanë obligu me do vendime të cilët janë shuma shume simbolike dhe këtu bin edhe personat me nevoja të veçanta të cilëve ju kemi ndihmu, po jo, ndoshta në përputhje se sa kishin mujt me përfitu me programet e tyre ne konkurrim, po që ju kemi ndihmu edhe dhunën në familje, se këtu bjen edhe ajo strehimorja të cilën e kemi ndihmu ne Gjilan. U përmend ndarja e mjeteve të çerdhes në Qifllak, të cilën jemi në përfundim e sipër, i kemi nda, po e kryem kismet, po e premi shiritin bashkë. Ka shumë pika që janë tu implementu, pikërisht për këtë ti duhesh me hek at mos votimi e buxhetit po duhesh me votu buxhetin për shkak se i hap rrugë edhe ekzekutives dhe vetvetes, ndoshta për një kritikë shume të sinqertë në implementim të saj, megjithatë është bindja e juaja. Bekimi preku shume çështje të cila nuk po du me i kontestua asnjë, po megjithatë ku është ajo e mirë që ne një ditë t'i rregullojmë çështjet e të ketë varreza në mirëmbajtje, në aspektin komunal. Disa lokalitete po i mirëmbajn vet, shkollën e vjetër kurrë nuk e kishim lan deri tash, gjithherë jemi tu majt ymyt, mos po muj me mrrri, por jemi në biseda me shume, që mos po muj me thith një donacion me të vërtet ta bëjmë të përdorshme edhe për ju mësimdhënësve edhe për nxënës po edhe për shoqata që do t'i instalojmë ato të cilat shume përputhen nga puna apo aftësimin që e bëjnë nxënësit. Unë besoj që pajtohesh plotësisht që ne nuk kemi palestër sportive, por krejt përpjekjet e tona kanë qenë që njëherë t'i nxjerrim prej lloqit, që pajtohesh edhe ti me ato asfalte që i kemi bënë fushatë, rimëkëmbjen ekomomike je tu e përcjell sikur unë, e bënë niveli qendror dhe aty janë të përfshira edhe kategoritë që thashtë Zoti le të kalon ai ligj dhe subvencionet e dyfishuara të cilat tha qeveria para dy tri dite që do ta prek shume Komunën e Vitisë, sepse është vend bujqësor blegtoral, ndoshta shumë do t'i ndihmojnë në atë vendim të cilin e ka marrë, tek rastet sociale ti e dinë që e ka pas vazhdimisht ministrit një rritje dhe ajo kategoria që kalon, ligji që do të përfundoj, ndërsa ne zakonisht kemi intervenu për ato që janë shumë ekstrem. Pajtoj me atë që e thave, ti nuk u kanë keq, ama nuk kemi mundësi, i kemi ndihmue me atë ndihmën që edhe kuvendi e murr vendimi po edhe donacionet që kanë ardh të ndryshme, e jemi mundu me i ndihmu familjen me asistencë sociale. Tek rrugët me zhavorr, kujtoj pa dash me i kritikua asnjë qeveri, vetëm një e di, që para shtat vite kur e kemi marr pushtetin, asnjë rrugë me zhavorr nuk ka qenë rrugë bujqësore. Unë mendoj që edhe 380 mijë nuk do të jen të mjaftuara që të gjitha tokat që janë të punueshme të ju ofrohet një komoditet fermerëve për me shku tek ara e vetë, sepse ka nevojë për këtë. Unë dëshiroj që asnjë arë as një tokë e punueshme mos te jetë pa u shtrur me zhavorr.

z.Rasim Terziqi: Tek investimet për vitin 2021, ndërtimi i urave 65 mije euro në Pozharan dhe Buzovik. Një pyetje për drejtorin: a është e përfshimë këtu edhe ndërtimi një ure atje tek lagjja "Korrani"? Pasi që te koka nderimi i kësaj rruge, vota ime do të jete pro këtij buxheti.

z.Ibrahim Rama, drejtor i financave: Disa përgjigje i dha nënkryetari. Kam tentu kësaj radhe me bë specifikim sa me adekuat, me pas me kuart projektet, po megjithatë nuk është bënë për plotë arsye, po një arsye këtë vit që ka ndodh është, se qarkorja e tretë na ka ardh në shtator, d.m.th deri në shtator ne nuk e kemi ditë asnjë fond saktë sa ka me qenë naj fond, që me projektin në investime nëpër të gjitha pjesët e investimeve kapitale, me ditë sakte sa rrugë kemi me i shtrur. Jemi kanë pak të hindikepum, përndryshe si projekcion këtë mënyrë që jemi tu e apliku, bile kemi qenë një nder komunat e para në Kosove që i kemi përgatit projektet e kodifikume. Këtë mënyrë siç është paraqit sot para juve, ligjërisht Ligji mbi Menaxhimin e Financave, në bazë të konsultimeve që janë bënë me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe Ministrinë e Financave, kodifikimi është ne rregull, nuk ka shkelje ligjore. Pjesa dërmuese e komunave e bëjnë ne këtë mënyrë. Arsye tjetër është ekzekutimi financiar i këtyre projekteve, sikur tash na ta bëjmë një listë të specifikuar pa mbulesë buxhetore, kemi me bë një gabim edhe politik, edhe profesional, se qytetari e mendon që ajo punë duhet mu realizu, buxhetet edhe vitet tjera i kemi kalu në këtë formë, po kur ti krahason projektin asfaltim të rrugës rurale, e shini që 95 rruge janë asfaltu me buxhetin e vitit 2020, që e keni miratu ju. I kemi të planifikuar mbi 12 fusha sportive që kanë me u rregullu me tepia të gomës dhe me rrethoja që janë projekte të paspecifikuara. Nuk ka të keqe në implementimin e atij projekti, edhe unë kërkoj që ju me e votu këto projekte, sepse kur të behet projekti në mënyrë detale, behet nga personat përgjegjës, nga kategoria për mallra dhe shërbime, hynë edhe mirëmbajtja e varrezave, e kemi rregulloren për këtë. P.sh. në kanalizime ishin disa kërkesa që 7 vite, 15 fshatra i kemi bënë me kanalizime të reja vjet edhe sivjet, nuk kemi fshatra në plotni që ju mungon kanalizimi, jemi tu bënë projekt për pjesë të lagjeve ku ka probleme të natyrave që nuk janë të këqyra, jemi tu bënë përpjekje me i rregullu këto defekte. Kërkoj miratimin e juaj për këtë pikë të rendit të ditës.

znj.Mirlinda Sadiku: E tha edhe drejtori, që buxheti është politik, është propozu edhe prej kryetarit. Më vjen mirë që edhe kolegu Nuredin dhe kolegu Avdi, që të dytë kanë qenë një zëri mu bë kyqja, mu rrit kapaciteti i fabrikës, mu kyç fshati Skifteraj e Budrikë, e Remnik. Nuk mundet me ardh asgjë para ujit prioritet. Sa i përket shujtave për fëmijë, kur është vizioni dhe misioni i një komune, është edhe politika të reja. Unë ë thash në fillim, asnjë politikë të re nuk e keni zhvillu që 7 vite, nuk ka politika të reja. Shujtat për fëmijë janë të domosdoshëm, tu e ditë që konsumojmë ushqim jo të shëndetshëm. Sa i përket subvencionimit, nënkryetar, këtu na ka ardh një raport i komitetit për persona më aftësi të kufizuara, ku kanë thanë nuk ja keni subvencionu një eskurzion, edhe shumë sinqerisht kam prit që doktoresha Xhylë do të del e të me mbështet për kërkesën, për 120 euro, për gratë lehona. Unë e di që ki presion politik, po megjithatë në vitin 2015 doktoresh jemi zotu që ta përkrahni dhe shumë komuna e kanë shti në buxhet. Ajo çka na intereson neve, a është i tepër fondi emergjent që e kërkojnë na në vitin 2021. Na po thojmë që pandemia do të na përcjell, a është e tepërt me nda pare për strategjinë kundër dhunës në familje, që është miratu në kuvend, a është e tepërt me ju ndihmu familjeve që i kanë hup me të dashurit e tyre, ne kërkojmë që këto kërkesa a do ti miratoni dhe të hedhen në votim. Keni të drejtë me e kundërshtu me votë.

z.Bekim Azizi: U dhanë një numër i madh i propozimeve dhe kush dul deri tani tha, që janë të arsyeshme dhe me një fjalë drejtori tha, që na nuk mujm kurgja me shti në këtë pjesë të buxhetit që jemi tu e miratu sot, se është propozim i kryetarit, deshni votone desh mos e votoni, kjo është gabim i qasjes dhe në bazë të kësaj nuk jep ky asnjë hapësirë me diskutu, as me votu këtë buxhet, sepse nëse drejtori është përnime një këshilltar i kryetarit, që nuk guxon me i lujte edhe çka të thotë ai më bë e me e lexu, na mujmë mos me e votu dhe nuk e votojmë, sepse nuk e përfill asnjë propozim që janë dhënë propozime të arsyeshme.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi nuk ka të tjerë për diskutim, unë e qes ne votim për miratim. Ju lutem me ngritje dore. Konstatoj që me 17 vota pro dhe 10 kundër miratohet projekt buxheti për vitin 2021.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për taksa, ngarkesa dhe gjoba për vitin 2021

z.Ibrahim Rama drejtor: Të nderuar, rregulloren për taksa, gjoba dhe ngarkesa e kemi analizu, e kemi obligim ligjo me buxhet të shkoj edhe kjo rregullore dhe propozim vendimi për tatimin në pronë. Këto dyja janë pjesë e buxhetit dhe duhet me i miratu me buxhet, për këtë i kemi përgatit me kohë të gjitha hallkat ligjore, i kemi konsultu me diskutim publik. Tani kërkoj nga ju që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e normave tatimore në pronën e paluajtshme për vitin 2021

z.Ibrahim Rama, drejtor: Me ligji e ri që e ka përgatit Ministria e Financave, gjegjësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, nuk ka nevojë ma komunat që të bëjnë rregullore mbi tatimin në pronë, ato i përgatit Ministria e Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë. Komunat i caktojnë vetëm normat tatimore, e ku ne kemi shku në minimumin e normave tatimore. Të gjitha normat që janë të lejuar nga Ministria e Financave, për të gjitha kemi shku në minimum tatimpagusit.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për debat, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu kjo pikë e rendit të ditës. Meqenëse u bashkëngjit edhe kryetari, e përshëndes, sepse e di që ka qenë me një takim në Prishtinë deri me tani.

Si pikë të gjashtë ë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-764, për plotësim ndryshimin e Vendimit Nr.01-110/05-370, të datës 08.05.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e ambulancës shëndetësore në Tërpezë

7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit Nr.01-110/05-546, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale NPSH “Arena Sport” në Kabash

8. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për krijimin e qasjes së parcelës Nr. 3760-0, në rrugën publike me nr.2592-11, përmes parcelës me nr.2582-6 dhe nr.2582-8

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne fillim të seancës ju thash, që i kemi tri pika për shfuqizim, pasi që janë të natyrës së njëjtë. Po i qes në votim për miratim piken e 6,7,8. Pasi që nuk ka për diskutim qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratuan pikat e cekura me lartë.

Si pikë të nëntë të rendit të ditës kemi:

9. Propozim vendim për miratimin planit të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2021

Kryesuesi z.Naim Pira: Këtë plan ju kemi dorëzuar me kohë edhe drejtorive, e kanë shiku a ki debat për këto dy pika. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dhjetë të rendit të ditës kemi:

10. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirimimin e znj.Hazire Gjela, anëtare e Komiteti për Komunitete në Komunën e Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Me kërkesën e saj e kemi sjell sot para juve këtë propozim vendim. Hapi debat për këto dy pika. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Ju falënderoj për kontributin që keni dhënë, mirupafshim në seancën e ardhshme.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 13:10 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
